




Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Në mbështetje të nenit 12 par. 2 pika "d", nenit 40.2 pika "c" të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisja Lokale, nenit 7 të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016, si dhe në bazë të nenit. 41 par. 2.pika "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me **31 mars 2016**, mori këtë:

VENDIM

PËR BARTJEN E MJETEVE TË PASHFRYTËZUARA (TË LIRA) NGA TË HYRAT VETANAKE NGA VITI 2015 NË VITIN 2016

1.Me këtë Vendim barten mjetet e lira të mbetura nga viti 2015 në vitin 2016 në shumën prej 459, 300.09 € në kategoritë ekonomike si në vijim:

1.1 Shuma e mjeteve në kategorinë e pagave dhe mëditjeve (kodi 111) në shumën prej 9, 201.00 €;

1.2 Shuma e mjeteve të bartura në kategorinë mallra dhe shërbime (kodi 130) në shumën prej 53,867.34 €;

1.3 Shuma e mjeteve të bartura në kategorinë shpenzimet komunale (kodi 132) në shumën prej 1,507.83 €;

1.4 Shuma e mjeteve të bartura në kategorinë subvencione dhe transfere (kodi 200) në shumën prej 10,803.01 €;

1.5 Shuma e mjeteve të bartura në kategorinë shpenzime kapitale (kodi 300) në shumën prej 383,920.91 €

1.6 Shuma e mjeteve të bartura nga të hyrat vetanake nga viti 2015 në vitin 2016 është **gjithsejtë 459, 300.09 €.**

2.Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë tabelat 4.1 dhe 4.2.

3. Me këtë vendim shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës 01.Nr.33/16 i datës 25.02.2016 me të cilin është bërë bartja e mjeteve financiare nga të hyrat vetanake nga viti 2015 në vitin 2016.

4.Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës dhe Drejtorja për Buxhet dhe Financa

5.Ky Vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Shpëtim Zhegrova



Kryesuesi i Kuvendit



Republika e Kosovës

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUÇITRN	
01 Nr. / Br	56/16
Nr. i fq. / Br. st	- 7 -
Data: / Datum	31. 03. 2016
VUSHTRRI - VUÇITRN	



Kuvendi i Komunës-Vushtri

Duke u Bazuar në Nenin 12.2 “d” të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetë qeverisje Lokale, nenin 41.2 “ç” të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me **31 mars 2016** mori këtë:

VENDIM PËR NDARJNE E MJETEVE FINANCIARE PËR BESARTA VËRBOVCIN

1.Me këtë vendim i ndahen mjete financiare Besarta Vërbovcit nxënëse në Kolegjin “Mehmet Akif”, në shumë prej njëmijë e pesëqind euro (1.500 €), e cila do të merr pjesë në Olimpiadën Ndërkombëtare “ International Project Olympiad” e cila do të mbahet prej datës 27 prill deri me 03 maj 2016 në Nairobi, Kenia.

2.Shuma e mjeteve të cekura në pikën 1 të këtij Vendimi do të ndahen nga kategoria subvencione dhe transfere, dhe kjo shumë ndahet në emër të Melihate Vërbovci nëna e të lartcekurës, për shkak se e njëjta është e moshës së mitur.

3.Nxënësjja Besarta Vërbovci pas kthimit nga gara në Keni, obligohet që t’i ofroj dëshmitë e pjesëmarrjes në Olimpiadën e lartcekur.


4.Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Arsim dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

5.Ky Vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Shpëtim Zhegrova

Kryesuesi i Kuvendit





Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Në mbështetje të nenit 12.2 "d" të Ligjit nr.03/L-40 mbi Vetëqeverisjen Lokale, nenit 41.2 "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, nenit 4.5 Udhëzimit Administrativ për Organizimin dhe Funkcionimin e Komiteteve Konsultative në Komuna Nr. 2008/10, si dhe duke u bazuar në propozimet e anëtarëve të kuvendit, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **31 mars 2016**, mori këtë:

VENDIM
PËR FORMIMIN E PANELIT PËRZGJEDHËS PËR ANËTARËSIM NË
KOMITETET KONSULTATIVE

1.Me këtë vendim formohet paneli përzgjedhës për anëtarësim në komitetet konsultative të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë në këtë përbërje:

- 1.1 Habib Mustafa, anëtar i kuvendit (PDK);
- 1.2 Habibe Gërzhaliu, anëtare e kuvendit (PDK);
- 1.3 Shkelzen Feka, anëtar i kuvendit (LDK);
- 1.4 Myrvete Hetemi, anëtare e kuvendit (LVV);
- 1.5 Isak Hyseni, nga shoqëria civile.

2. Paneli përzgjedhës i cekur në pikën 1 të këtij vendim do të ketë për obligim intervistimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve si dhe do ti propozoi kuvendit listën me kandidat për anëtarësim në komitetet konsultative.


3. Për Zbatimin e këtij vendimi obligohen: paneli i cekur në pikën 1 të këtij vendimi dhe Sekretaria e Kuvendit.

4. Ky Vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Shpëtim Zhegrova

Kryesuesi i Kuvendit





Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Në mbështetje të nenin 73 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 56 paragrafi 1,2 dhe 3, dhe nenit 57.1 të Statutit të Komunës, si dhe nenin 4.2 të Udhëzimit Administrativ për Organizimin dhe Funkionimin e Komiteteve Konsultative në Komuna Nr. 2008/10, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur me **31 mars 2016** mori këtë:

V E N D I M
PËR SHPALLJEN E KONKURSIT PËR ANËTARËSIM NË KOMITETET
KONSULTATIVE

1.Me këtë vendim shpallet konkursi për anëtarësim në këto komitetet konsultative të KK-së:

- 1.1 Komiteti për Arsim, Kulturë, Fe, Sport dhe Rini (7 anëtarë);
- 1.2 Komiteti për Zhvillim Ekonomik dhe Shërbime Publike (7 anëtar);
- 1.3 Komiteti për Urbanizëm dhe Mbrojtjen e ambientit (7 anëtar);
- 1.4 Komiteti për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale (7 anëtarë);
- 1.5 Komiteti për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore (7 anëtarë);
- 1.6 Komiteti për Personat me Nevoja të Veçanta (7 anëtarë).

2.Kushtet e konkursit duhet të jenë në përputhshmëri me nenet 4.1, 4.3 dhe 4.4 të Udhëzimit Administrativ të MAPL-së nr. 2008/10.

3.Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryesuesi dhe Sekretaria e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

4. Ky Vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Shpëtim Zhegrova

Kryesuesi i Kuvendit



Republika e Kosovës

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITRAN
01 Nr. / Br <u>59/16</u>
Nr. i fq. / Br. st <u>-1-</u>
Data: / Datum <u>31.03.2016</u>
VUSHTRRI - VUČITRAN




Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Bazuar në nenin 11,12 dhe 40.2”c” të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 41.2 “ç” të Statutit të komunës, Vendimit të KK-së 01.Nr.38/16, dt.25.02.2016 me të cilin janë aprovuar subvencionet për klubet dhe shoqatat sportive për vitin 2016, si dhe duke u bazuar në propozimin e kryesuesit të kuvendit Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më **31 mars 2016**, mori këtë:

**VENDIM
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR KLUBIN E FUTBOLLIT FC-
VUSHTRRIA**

- 1.Me këtë vendim klubit të futbollit FC-Vushtrria i ndahen mjete financiare në vlerë prej katër mijë euro (4.000 €), për zhvillimin e aktiviteteve të tij.
- 2.Mjetet financiare të cekura në pikën 1 të këtij vendim ndahen nga fondi për transfere dhe subvencione nga pozicioni stimulimi për sukseset e klubeve.
3. Për Zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport si dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Ky Vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.



Shpëtim Zhegrova

Kryesuesi i Kuvendit



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPSTINA VUČITRN	
01 Nr. / Br	60 / 16
Nr. i fq. / Br. st	- 1 -
Data: / Datum	31. 03. 2016
VUSHTRRI - VUČITRN	



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtri

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më **31 mars 2016**, pas shqyrtimit të Draft-Rregullores për Dekorata duke u bazuar në nenin 12.1 pika "c" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neni 12 të Statutit të Komunës, neni 7-të të Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2013 për transparencë nëpër komuna, si dhe neni 2 të Rregullores për Transparencë 01Nr.99/13, dt. 25.04.2013, mori këtë:

V E N D I M PËR DHËNIE NË DISKUTIM PUBLIK

1. Jepet në diskutim publik Draft-Rregullorja për Dekorata.
2. Diskutimi publik fillon nga data 04 prill 2016 dhe zgjatë deri më 22 prill 2016.
3. Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmer masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna, dhe konform neni 9.2 dhe 9.4 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.
4. Obligohet Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRS) që si hartues dhe propozues i Draft-Rregullores në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 05/2013, dhe neni 9.5 të Rregullores për Transparencë 01 Nr.99/13, dt. 25.04.2013.
Gjithashtu DKRS -ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të Draft-Rregullores në fjalë në mbledhjen e KK-së në muajin prill 2016.
5. Ky Vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Shpëtim Zhegrova



Kryesues i Kuvendit